

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm,** Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. S. nga fsh. M. K. Gjakovë, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.9/2016 të datës 08.02.2016, për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë **06.04.2017**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të akuzuarit, të dëmtuarit, në të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **S. S.** nga i ati A. dhe e ëma A. e gjinisë A., i lindur me ... në fsh. M. K. Gjakovë, ku dhe tani banon, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, punoi në botën e jashtme në Gj., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

#### **Ë s h t ë f a j t o r :**

**Sepse: Me** datën 26.11.2015 rreth orës 12.30 në fshatin M. K. Gjakovë respektivisht në shtëpinë e tij i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete e merr nga i dëmtuari – vëllai i tij A. S. 30 Euro para të gatshme dhe 5 telefona celular: 1 HTC-Uan, 1 Samsung, 1 Hawai, 1 S-4 dhe 1 Noto-1 të gjitha këto në vlerë prej 800 Euro dhe dy telefona Iphone 4 në vlerë prej 200 Euro dhe të njëjtit telefona të gjithë ua shet tre personave të ndryshëm të panjohur tek sheshi Skënderbeu në Gjakovë në vlerë prej 250 Euro, të cilat para i shpenzon për nevojat të veta në Tiranë dhe Prishtinë, ndërsa të dëmtuarit i shkakton dëm të konsiderueshëm material.

- me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes, nga neni 325 par.1 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4,41,46,50,51,73, dhe nenit 325 par.1 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës.

### **G J Y K O N**

Dënim me gjobë në shumë prej **100 (Njëqind) Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **5 (pesë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-€.(njëzet) euro, të gjobës.**

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej **30 Euro**, e krejt këtë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari A. S. nga fsh. M. K. Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.9/2016, të datës 08.02.2016, kundër të akuzuarit S. S. nga fsh. M. K. Gjakovë, për shkak të veprës penale të vjedhjes, nga neni 325 par.1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit S. S., andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari S. S. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë, deklaron se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, për të cilën veprë jam penduar pa masë, vëllaut tim i kam kërkuar falje për veprën e bërë si dhe kam kompensuar në tërësi dëmin që ia kam shkaktuar vëllaut tim, në atë kohë kam qenë shumë i rij duke mos i ditur pasojat e kryerjes së veprës, tani kam filluar të punoi në botën e jashtme në Gjermani, kam marr vizën e punës, kontribuoi në familje, dhe premtoi se në të ardhmen nuk do të përsërisë të njëjtën.

I dëmtuari A. S. deklaron se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk kërkoi kompensim të dëmit, dëmin e shkaktuar vëllau im më ka kompensuar në tërësi, më ka kërkuar falje për veprën e bërë dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë të njëjtën, është e vërtetë që veprën nuk e ka përsëritur, ne jetojmë së bashku në një shtëpi, është përmisuar, tani punon në Gjermani, ka lejen e punës dhe herë pas herë na ndihmon familjen, prandaj unë si palë e dëmtuar i propozoi gjykatës që ti shqiptoi një dënim sa më të butë.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet ne faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tersi u vërtetua se i akuzuari S. S.: Me datën 26.11.2015 rreth orës 12.30 në fshatin M. K. Gjakovë respektivisht në shtëpinë e tij i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete e merr nga i dëmtuari – vëllau i tij A. S. 30 Euro para të gatshme dhe 5 telefona celular: 1 HTC-Uan, 1 Samsung, 1 Hawai, 1 S-4 dhe 1 Noto-1 të gjitha këto në vlerë prej 800 Euro dhe dy telefona Iphone 4 në vlerë prej 200 Euro dhe të njëjtit telefona të gjithë ua shet tre personave të ndryshëm të panjohur tek sheshi Skënderbeu në Gjakovë në vlerë prej 250 Euro, të cilat para i shpenzon për nevojat të veta në Tiranë dhe Prishtinë, ndërsa të dëmtuarit i shkakton dëm të konsiderueshëm material.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se

I akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: i gjendjes se dobët ekonomike, sjelljet korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, sidomos duke marrë parasysh faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin, dhe i dëmtuari nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim të dëmit, dëmin e shkaktuar të dëmtuarit vëllaut të tij e ka kompensuar në tërësi, si rrethanë rënduese Gjykata muar parasysh peshën e veprës së kryer penale, mënyrën e kryerjes së veprës, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se dënimin me gjobë në shumë prej **100 (Njëqind)Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nën par.2.6 të KPP-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**P.nr.72/16 me datë 06.04.2017**

**Sekretarja juridike**  
**Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,**  
**Diana Sina**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.